25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike.....

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve.....

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____

Çmimi Neto pa TVSH	
TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. **AKTIVITETI :**

Asambleja e Përgjithshme dhe Forumi i Biznesit të PostEurop në Tiranë, Shqipëri, 7-10 tetor 2025, pritur nga Posta Shqiptare Sh.A.

2. VENDI I ZHVILLIMIT TË ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME DHE FORUMIT TË BIZNESIT TË POSTEUROP

Eventi duhet të zhvillohet në një vend, ambjent apo hotel, sallat e të cilit të ndodhen në afërsi të Drejtorisë së Përgjithshme (Selia Qendrore) të Postës Shqiptare Sh.A., pasi Drejtuesit e Lartë të Postave Evropiane (CEOt) dhe delegate të tjerë të nivelit të lartë, gjatë mbledhjeve, do të duhet të lëvizin nga sallat e mbledhjeve për të shkuar dhe zhvilluar takime bilaterale në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare Sh.A. dhe pas takimeve të kthehen përsëri në mbledhje.

Gjithashtu, duke u zhvilluar mbledhjet në këto vende, CEO-t dhe delegatët e tjerë të nivelit të lartë, ndodhen njëkohësisht afër qendrave muzeale, turistike të qytetit dhe kanë mundësi t'i vizitojnë ato duke kursyer shpenzimet për transport, që duhen për aksesimin e tyre.

Për më tepër, zhvillimi i mbledhjeve të lartpërmendura në vendet dhe ambientet e lartpërmendura është njëkohësisht afër hotelit/eve ku organizatorët e eventit (PostEurop), CEOt dhe delegatët e nivelit të lartë të mbledhjeve në fjalë do të qëndrojnë me shpenzimet e tyre.

Ambienti duhet të disponojë disa salla mbledhjesh, pasi përveç sallave që kërkohen në këtë procedure, organizatorëve i'u duhen për disa mbledhje të tjera, disa salla të tjera me kapacitet më të vogël, të cilat nuk përfshihen në këtë procedure dhe mbulohen financiarisht nga organizatorët, por takimet do të zhvillohen paralelisht me mbledhjet e sallave të kërkuara në këtë procedure.

3. SALLAT E MBLEDHJEVE NË DISPOZICION :

3.1 Specifikimet e sallave :

3.1.a Salla e sekretariatit:

Kjo dhomë duhet të jetë plotësisht e pajisur dhe funksionale që nga dita e parë (data 6 tetor). Ajo duhet të jetë në dispozicion (të sigurohet) nga Operatori Ekonomik (OE) për 4 ditë.

Kjo dhomë e Sekretariatit të Zyrave Qendrore duhet të përmbajë:

- Dy tavolina dhe disa tabela me sipërfaqe të madhe + 20 karrige
- Dy kompjuter të pajisur plotësisht me software në anglisht (me internet dhe softwar-in outlook të instaluar) dhe mundësisht me tastierë AZERTY (ose ekuivalente), funksional dhe në punë nga e hëna deri të enjten. Të dy kompjuterët duhet të instalohen në dy tavolina të veçanta.
- 2 printera laser të lidhur me këta dy kompjuterë dhe plotësisht funksionalë dhe në punë që nga dita e parë.
- Lidhja pa pagesë WIFI duhet të jetë e disponueshme në dhomën e Sekretariatit.
- Dy fotokopjues me ngjyra shumëfunksionale (me kapëse nëse është e mundur) dhe opsion renditje dhe një kapacitet prej 80 faqe/minut, gjithashtu plotësisht funksional dhe në punë (Shihni të dhënat më sipër).
- Një nga printerat shumëfunksionalë, ose të dy, duhet të kenë funksion skanimi operacional dhe të dy printerët duhet të jenë të lidhur me kompjuterat e listuar më lart.

NB: Për aparatet fotokopjuese me ngjyra shumëfunksionale, duhet të jetë gjithmonë pranë për të 4-ta ditët, datë 6,7,8,9 tetor 2025 një teknik fotokopjues.

- 1 risëm letre A4 (1 risëm = 500 fije)

3.1.b Sallë për Kryetarin e Bordit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Bordin Drejtues

Salla për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, dhe Bordin Drejtues duhet të parashikohet për 20 persona.

Konfigurimi i sallës së mbledhjeve duhet të ketë tavolina me sipërfaqe të madhe + 20 karrige, duke përfshirë ekran(screen) +beaner /projektor .

3.1.c Salla e Asamblesë dhe Forumit të Biznesit:

Salla e Asamblesë së Përgjithshme dhe Forumit të Biznesit duhet të jetë në dispozicion (të sigurohet) nga Operatori Ekonomik (OE) për **3 ditë** (duke përfshirë 1 ditë për përgatitjen, 1 ditë për Asamblesën e Përgjithshme dhe 1 ditë për Forumin e Biznesit, respektivisht datat 7,8,9 tetor 2025).

Instalimi i pajisjeve (sistemit të zërit, altoparlantëve, mikrofonave, kufjeve, sistemit të ndriçimit, mobiljeve, skenës dhe tabelat(shenjat) me emrin e shtetit) duhet të finalizohen deri **pasditen e ditës para** fillimit të Asamblesë së Përgjithshme, pra pasditen e datës 8 tetor 2025. Menaxheri i Komunikimit të organizatorit PostEurop do të ketë një takim në terren me ekipin teknik një ose dy ditë përpara Asamblesë së Përgjithshme.

Vendosja e tavolinave duhet të jetë e optimizuar për të gjithë pjesëmarrësit. Ajo është në **modelin e një klase për 160 persona**, duke pasur/siguruar edhe struktura të tjera alternative dhe krijuese për të siguruar një hapësirë (zone) më të mirë për diskutime. Si dhe sfondin mbrapa me simbolet e Asamblesë së Përgjithshme, dhe e plotësuar me materialet promociionale përkatëse.

Të merren masat që para Asamblesë së Përgjithshme të bëhet një provë teknike mbi funksionimin normal të elementeve të kërkuara.

Salla duhet të jetë e pajisur në mënyrë të tillë:

- Përballë sallës duhet të vendoset një skenë që lejon deri në 5 persona (ulur) + foltore. Është e preferueshme që foltorja e altoparlantit pak majtas ose djathtas të ekranit me brandin e eventit (logo në vijim).



- **Tavolina** dhe **karrige** për të gjithë pjesëmarrësit në stilin e klasës (vendosja duhet të konfirmohet në varësi të formës së dhomës, numrit të pjesëmarrësve që duhet të jetë 160)
- **Letër, stilolapsa** dhe **fletore** të branduara në tavolina për secilin pjesëmarrës, pra për 160 persona. Po ashtu edhe shishe uji për secilin pjesëmarrës, për secilën nga ditët.

-
- Kërkesa teknike që duhet të plotësojë salla që do të ofrohet nga Operatori Ekonomik (OE) duhet të ketë karakteristikat (**specifikat**) **AV (audio vizive)** që vijnë:
 - **Sistemi i ndriçimit dhe zërit** për sallën e mbledhjeve. Kjo përfshin gjithashtu ndriçimin e saktë të skenës
 - **Tekniku(ët) në vend** për t'u kujdesur për konfigurimin teknik, regjistrimin, problemet teknike gjatë gjithë kohëzgjatjes së takimit.
 - **Switch (çelës apo komandues) për të mundësuar shfaqjen e videove** të lidhura me një projektor për projeksionin në ekranin e madh.
 - **Një laptop prezantimi** i lidhur nëpërmjet LAN dhe i vendosur në foltoren e altoparantëve dhe i lidhur me projektorin me telekomandë për të mundësuar ndryshimin e faqeve (slide-ve)
 - Deri në tre **monitorë** të instaluar përballë skenës (të lidhur me projektorin S/VGA dhe videoprojektorin) për folësit dhe personat e tjerë në skenë për të parë slide-t / videot e shfaqura)
 - **Një ekran i madh projekcioni** pas skenës, me përmasa 4m x 3m midis dy tavolinave të instaluar në skenë
 - **Mikrofona** me valë (pa tel) për folësit
 - **Mikrofona** tavoline (1 mikrofoni për 2 delegatë)
 - **Priza elektrike** ose një stacion karikimi për të gjithë pjesëmarrësit.
 - **Regjistrues digjital** për regjistrim audio të të gjithë takimit (në gjuhën origjinale) – me mundësi regjistrimi të seancave dhe transferimit të tij në USB ose dërgimit të skedarit në mënyrë elektronike direkt te kontakti i caktuar i PostEurop (detajet e kontaktit të konfirmohen) nëse po, në do të preferonim opsionin e fundit.
 - **Paketa opsionale e transmetimit** që lejon transmetimin e drejtpërdrejtë të eventit në dy ditët në MSTEams (ose Zoom) dhe lejon pjesëmarrësit në internet të ndërveprojnë me konferencën. Këto pajisje teknike duhet të lejojnë organizimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe Forumit të Biznesit në formatin hibrid, me pjesëmarrje në distancë të një pjese të caktuar të delegatëve.
 - OE duhet të marri masat që të sigurojë që salla të jetë sistem klase ose ekuivalente sipas planimetrisë së mëposhtme.



3.1.d Përmbledhja tabelare e shërbimeve për sallat e vëna në dispozicion

Emërtimi Sallave	Nr.i personave	Datat në dispozicion	Nr. i ditëve që kërkohet shërbimi
Salla e sekretariatit:	20	6,7,8,9 Tetor	4
Sallë për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, Bordin Drejtues	14	7,8,9 Tetor	3
Salla e Asamblesë dhe e Forumit të Biznesit:	160	7,8,9 Tetor	3

4 TAVOLINA E REGJISTRIMIT / TAVOLINA E INFORMACIONIT

Në hyrje të sallës së Asamblesë së Përgjithshme, duhet të vendosen dy tavolina për të shërbyer si Tavolina Regjistrimi në mëngjesin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme në datë 8 tetor 2025 dhe gjithashtu në ditën e Forumit të Biznesit (datë 9 tetor 2025).

Për këtë duhet të përgatiten dy tavolina (me mbulesë) dhe dy karrige për secilën tavolinë.

Duhet gjithashtu një tabelë me informacion orientues në hollin para mbledhjeve të mësipërme.

5 PUSHIM KAFE + BISKOTA/ TË NGJASHME GJATË EVENTIT:

- Pushim kafe **permanent (gjatë gjithë kohës sipas kërkesës)**, për **4 ditë** (6,7,8,9) për sallën e sekretariatit për **20 persona**.
- Pushim kafe **permanent (gjatë gjithë kohës sipas kërkesës)**, për **4 ditë** (6,7,8,9) për sallën e Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm për **5 persona**.
- Pushim kafe **2 herë në ditë**, në mëngjes dhe pasdite, për datën 8 dhe 9 tetor 2025, për Asamblenë e Përgjithshme dhe Forumin e Biznesit , për **160 persona**.
- Pushime kafe+ biskota për bordin drejtues në takimin e datës 7 tetor 2025, për **1 ditë** për **12 persona**.

6 DREKA

- Dreke bufe për 160 persona, datë 8 tetor 2025, të ndara në dy ambjente/dhoma , në njerin ambjent **dreke bufe për 100 persona/delegatë**, me ujë e pije freskuese, pa pije alkoliqe, kurse ambjenti/dhoma tjetër me **dreke bufe për 60 persona(CEOt)**, duke përfshirë pak verë të bardhë dhe të kuqe.
- Dreke bufe për të gjithë delegatët, 160 persona, datë 9 Tetor 2025, me ujë e pije freskuese, pa pije alkoliqe.

7 DARKA

Pritje koktej mirsëardhje, darkë buffet për **140 persona**, datë 7 tetor 2025, në të njëjtin vend ose pranë ambjenteve ku janë sallat e mbledhjeve, duke përfshirë (snacks), ujë, pije freskuese dhe pije alkolike.

Darkë bufet e largimit (Farewell) për **140 persona**, datë 9 Tetor, duke përfshirë ushqim bufe, ujë, pije freskuese dhe pije alkolike, në një vend/restorant që demonstroi vlerat dhe traditat shqiptare, me elemente tradicionale, por njëkohësisht të jetë afër afër hotelit/eve ku organizatorët e eventit (PostEurop) dhe CEOt dhe delegatët e nivelit të lartë të mbledhjeve në fjalë do të qëndrojnë me shpenzimet e tyre. Kjo për lehtësi aksesimi dhe për të kursyer shpenzimet për transport, që duhen për aksesimin e tyre.

PËRMBLEDHJA E SHËRBIMEVE PËR PUSHIM KAFE,USHQIM, TË NGJASHME.

Emërtimi	Numri i personave	Datat në dispozicion	Nr. i diteve të shërbimit të kërkuar
Pushim kafe + biskota për sallën e sekretariatit	20	6,7,8,9 Tetor	4
Pushim kafe + biskota për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe të ftuarit	5	6,7,8,9 Tetor	4
Pushim kafe + biskota për Bordin Drejtues	12	7 Tetor	1
Pritje koktej mirsëardhje (darkë bufe)	140	7 Tetor	1
Drekë bufe për pjesëmarrësit (me ujë dhe pije freskuese), pa alkol	100	8 Tetor	1
Drekë bufe për CEO-t me ujë, pije freskuese dhe pak verë të kuqe/bardhë	60	8 tetor	1
Drekë bufe për pjesëmarrësit me ujë dhe pije freskuese, pa alkol	160	9 Tetor	1
Darkë bufe e largimit për pjesëmarrësit (Farwell)	140	9 Tetor	1

8 EKSKURSION PËR DELEGATËT, TË FTUARIT DHE SHOQËRUESIT NË

QYTETIN E KRUIJËS

Operatori Ekonomik (OE) duhet të sigurojë/organizojë me shpenzimet e veta ekskursionin e pjesëmarrësve dhe shoqëruesve të tyre në qytetin e Krujës. Kjo do të thotë që ai duhet të sigurojë:

1. Transportin nga Tirana – Krujë -Tiranë për **40 pjesëmarrës**. Ky shërbim transporti të ofrohet me **3 automjete të tipit minivan 15+1** në dispozicion gjatë gjithë ditës.
2. Bileta për të vizituar Muzeun Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu i njohur edhe si Muzeu i Krujës për **40 pjesëmarrës**.

3. Dreka në një vend/restorant në qytetin e Krujës për **40 pjesëmarrës**.

PËRMBLEDHJA TABELARE E EKSKURSIONIT

Emërtimi	Numri personave	Datat në dispozicion	Nr. i diteve të shërbimit të kërkuar
Transportin nga Tirana – Krujë – Tiranë (me minivan)	40	10	1
Bileta për të vizituar Muzeun Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu	40	10	1
Dreka në një vend/restorant në qytetin e Krujës për pjesëmarrësit	40	10	1

9 MATERIALET PROMOCIONALE TË EVENTIT (ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË POSTEUROP DHE FORUMIT TË BIZNESIT)

9.1 Roll-Up Promocional për Asamblenë e Përgjithshme të POSTEUROP

3 Roll-up me mekanizëm: Përmasat 200 cm x 85 cm. Materiali: PVC. Printuar me 4 ngjyra, U.V., branduar me logon e eventit. Tematika, imazhet dhe teksti që do përmbajë baneri i roll-up do miratohen nga Posta Shqiptare.

9.2 Broshurë Promocionale për Asamblenë Përgjithshme të PostEurop

Qëllimi: Informim dhe orientim për delegatët pjesëmarrës në Asamblenë e Përgjithshme të PostEurop, tirazhi: 160 copë, formati final A4(i mbyllur): 21 x 29.7 cm, formati i hapur: A3 42 x 29.7 cm (me palosje në mes), kapak: 200 gsm, letër art, e plastifikuar në laminim mat, faqe të brendshme: 200 gsm, letër art (cilësi e lartë, për printim me ngjyra), lidhja: me tel (stapled), printim: 4/4 (ngjyra të plota në të dyja anët – full color), logo e dedikuar për eventin:

Broshura do të përbëhet nga 24 faqe TOTAL (20+4). Dizajni dhe teksti i broshurës do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

Elementët grafikë të përfshirë në broshurë:

- Përshtatja e logos së eventit në kopertinë dhe faqet hyrëse
- Fotografi nga vendi pritës, ambientet e takimit, aktivitetet
- Ikona dhe simbole për orientim vizual
- Hartë orientuese e vendndodhjes së hotelit dhe ambienteve të tjera
- Informacion i qartë dhe i organizuar sipas tematikave të delegatëve
- **NUK duhet të përmbajë LOGON e organizatorit PostEurop.**



1. Përshtatja e Logos së Eventit të Dedikuar për Asamblenë e Përgjithshme

Logoja zyrtare e eventit të Asamblesë së Përgjithshme do të vihet në dispozicion të Operatorit Ekonomik (OE) nga Autoriteti Kontraktor (AK), pas nënshkrimit të kontratës, në format vektorial, për të garantuar cilësi të lartë në riprodhim grafik.

Operatorit Ekonomik do të përshtasë logon grafikisht me dizajnet përkatëse të materialeve promocionale, duke respektuar udhëzimet vizuale të markës dhe ngjyrat zyrtare të ngjarjes.

Të sigurojë pozicionim të dukshëm dhe koherent të logos në të gjitha produktet: broshura, roll-up, bexha, ftesa dhe çdo material tjetër informues ose prezantues.

9.3 Set Materialelesh Logjistike të Personalizuara për Konferencë

Përbërësit e setit:

- **Çantë kartoni** me logo të personalizuar, materiali: karton 250–300 gsm, i qëndrueshëm, **Ngjyra:** Printim me ngjyra – logoja e eventit(Asamblesë së Përgjithshme të PostEurop) dhe Postës Shqiptare Sh.A. në të dy anët, **Madhësia:** e përshtatshme për të mbajtur broshura A4 dhe blloqe shënimesh, doreza: Litar pambuku ose letër të përdredhur, sasia e kërkuar: 160 copë.
- **Bllok shënimesh** (notepad), **Formati:** A5 (14.8 x 21 cm), 30–40 faqe, pjesa e brendshme letër 80 gsm me vija të vija lehta për shënime, ku në pjesën fundore të jetë printuar logo e konferencës, **Kapaku:** i personalizuar me logon e konferencës. Materiali i kapakut: 250 gsm, i printuar dhe plastifikuar në mat. **Lidhja:** Me spiralë metalike ose ngjitje klasike; 160 copë
- **Stilolaps plastik, Materiali:** Plastikë cilësore, me permasa 14.2 cm x 1 cm, ngjyra e plastikës kombinimi i bardhë dhe gri (sipas kodit të ngjyrave të përcaktuara për Asamblenë), hapësirë stampimi 2 cm x 0.8cm shtypje ose gravurë me logon e konferencës, bojë shkrimi blu. 160 copë

9.4 Baner promocional

OE duhet të sigurojë **1 Baner me strukturë druri** për përdorim në ambiente të brendshme ose të jashtme për pjesën hyrëse të eventit. **Përmasat:**Gjerësia: 4 metra, Lartësia: 3 metra, Sipërfaqe e printuar: 12 m² **Struktura mbajtëse:**Dru. **Sipërfaqja e banerit Material:** PVC, **Printim** në 4 ngjyra me rezolucion min. 720 dpi. **Fiksimi me:** Grepa metalikë ose sistem tensioni me litar dhe kapëse për ta mbajtur të tendosur.

Përmbajtja grafike:


- Logo e konferencës / Asamblesë Gjenerale (në format vektorial)
- Titulli i eventit dhe data
- Grafika zyrtare e përzgjedhur për konferencën (sipas manualit vizual të dedikuar)
- Ngjyra bazë: në përputhje me manualin grafik të eventit
- Kodet e ngjyrave do të specifikohen nga dizajneri grafik zyrtar në dorëzim të skedarit për printim.

9.5 Bexha dhe Litarë

OE duhet të sigurojë 180 bexha dhe 180 litarë

9.5.1 Bexha (Badge ID)

- Materiali: Plastik i fortë transparent (PVC ose polikarbonat)
- Dimensionet standarde: 9.5 cm (gjatësi) x 6.5 cm (gjerësi)
- Forma: Rektangulare me cepa të rrumbullakosur
- Mbajtës: Me fole të përforcuar për lidhje me litar
- Shtypje/ Teksti : Printim me logon e eventit + emër/rol pjesëmarrësi)



9.5.2 Litarë për bexha

- Materiali: Poliester i qëndrueshëm, pëlhurë cilësore
- Gjatësia: 90 cm total (45 cm e palosur) Gjerësia: 1– 1.5cm
- Ngjyra: E përshtatur me ngjyrat e logon e eventit
- Shtypja: Logo e eventit (me teknikë sublimimi ose screen printing) në të dy anët
- Kapëse: Me karabinë metalike ose plastike cilësore për lidhje me bexhin.

10 Trekëndësh protokollar me emrat e delegacionit dhe vendit pjesëmarrës

Trekëndësh protokollar (tabelat e emrave), 160 copë për përdorim mbi tavolinat e delegacioneve në konferenca dhe evente zyrtare ndërkombëtare për të identifikuar përfaqësuesit dhe vendet pjesëmarrëse.

- Përmasat e hapura: 30 x 17 cm
- Palosje: 4 palosje (kryesisht për stabilitet dhe qëndrueshmëri të formës trekëndore)
- Përdorim në dy anë: Printim nga të dyja anët për dukshmëri nga të dy drejtimet në tavolinë
- Format i mbyllur / formë finale: trekëndësh që qëndron vetë në tavolinë

Materiali: Letër karton: 300 gr/m², Celefonim mat për një pamje elegante dhe reduktim të ndriçimit reflektues, Printim: Full Color, përshtatur me ngjyrat e logon e eventit.

Pamja vizuale: Emri i vendit: në pozicionin qendror, me shkronja të mëdha dhe të lexueshme

Logo e eventit në qoshe të poshtme të kartonit. Gjuha: Anglisht (ose dygjuhëshe nëse është kërkesë zyrtare). në rendin alfabetik anglez të Vëndit (me emrin e kompanisë dhe emri i vëndit duhet të tregohet në tabelat e emrave).

11 Ftesë zyrtare për eventin

Ftesa zyrtare për Asamblenë e Përgjithshme: 160 copë, Përmasat: 17 x 11 cm (horizontal ose vertikal, sipas dizajnit) **Materiali:** Letër cilësore kartoni 200 gr/m² celefonim mat.

Printimi: Full Color në një anë, logo, dizajn i personalizuar i eventit, titulli, vendi, data, teksti i ftesës. Dizajni dhe teksti i broshurës do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

12 Shërbim Fotograf/ Videograf

Operatori Ekonomik duhet të verë në dispozicion të Asamblesë dhe Forumit të Biznesit një fotograf dhe videograf për tri ditë të plota, konkretisht datat 7, 8 dhe 9 tetor 2025, respektivisht me oraret që vijojnë: data 7 tetor nga ora 9:00-22:00, data 8 tetor nga ora 9:00-23:00, ndërsa data 9 tetor nga ora 09:00-23:00, një fotograf dhe një videograf, për të bërë fotografi dhe video të mbledhjeve dhe eventeve sociale (prijtje e mirëseardhjes dhe darka e lamtumirës, etj.).

13 Printim Foto Eventi

Operatori Ekonomik (OE) duhetë printojë/stampojë **160 fotografi të të gjithë pjesëmarrësve/delegatëve** (Family photo).

- Formati i fotos: Dimensioni standard: 15 x 21 cm (A5) – më elegant për evente zyrtare ose 10 x 15 cm – nëse do përdoret për shpërndarje masive si kujtim.
- Letra për printim: Letër fotografike glossy ose ekuivalente (me shkëlqim) ose silk/mat në varësi të preferencës vizuale.

14 Mbajtëse Fotografie

Mbajtëse fotografie, 160 copë, me 4 prerje për vendosje dhe shpërndarje të fotografisë zyrtare të grupit të delegacioneve në kuadër të eventit Asambleja e Përgjithshme.

Përmasat e hapura: 33 x 21 cm, **Materiali:** Karton cilësor 300 gr/m², telefonim mat.

Dizajn: Sipas grafikes së personalizuar për eventin, Logo e Asamblesë së Përgjithshme, emërtimi i plotë i eventit dhe data, element dekorativ institucional/protokollar, ngjyrat zyrtare të (sipas kodit të dizajnit).

15 Dhuratë për pjesëmarrësit e eventit

OE duhet të sigurojë për shpërndarje **160 dhurata/suveni** për pjesëmarrësit e Asamblesë së Përgjithshme. Në varësi të zgjedhjes, dhurata mund të përfshijë souvenir me vlerë simbolike, me peshë dhe përmasa të tilla që të ta zerë/përfshijë çanta e kartonit të materialeve promocionale të eventit.

16 Përgatitja e një postacioni për ekspozim dhe shitje të pullave postare/produkteve filatelike në holl që të përmbushë funksionin promovues, estetik dhe shitës të tyre.

Përgatitja e Postacionit për Pulla Postare / produkte filatelike në Holl për promovim dhe shitje të pullave postare dhe produkteve të tjera filatelike si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe simbolikës kombëtare.

Organizimi i këtij postacioni duhet të përfshijë:

- Tryezë ekspozimi (1 copë), e thjeshtë, 160 cm e gjatë, me mbulesë branduar me logon e Postës Shqiptare dhe dizajn filatelik.
- Stendë roll-up (1 copë), me vizual të dedikuar për filateli/pulla postare (85x200 cm).
- Raft i vogël ekspozimi, për vendosje vertikale të koleksioneve ose katalogëve.

▪ **PËRMBLEDHJA E SHËRBIMEVE PËR MATERIALE PROMOCIONALE**

Emërtimi	Sasia
Roll-Up Promocional për Asamblenë e Përgjithshme të POSTEUROP	3
Broshurë Promocionale për Asamblenë Përgjithshme të PostEurop	160
Përshtatja e Logos së Eventit të Dedikuar për Asamblenë e Përgjithshme	
Set Materialesh Logjistike të Personalizuara për Konferencë (të shpjeguara më lart) që përmban : Çantë kartoni, Bllok shënimesh, stilolaps, fletore	160
Baner promocional	1
Bexha dhe Litarë	180
Trekëndësh protokollar me emrat e delegacionit dhe vendit pjesëmarrës	160
Ftesë zyrtare për eventin	160
Fotografi të printuara (Family foto)	160
Mbajtëse Fotografie	160
Dhurata	160
Postacioni për ekspozim dhe shitje të pullës postare/produkteve filatelike (detajuar me të gjitha elementet më lart)	1

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: Organizimi, përgatitja, mbështetja teknike dhe logjistike, si dhe menaxhimi i ambientit për zhvillimin e eventit gjatë periudhës 06-10.10.2025.

Afatet e ekzekutimit: 5 (pesë) ditë kalendarike, nga 06.10.2025 deri në 10.10.2025, pavarësisht datës së lidhjes së kontratës.

Emërtimi i Sallave	Nr.i personave	Datat në dispozicion	Nr. i ditëve që kërkohet shërbimi
Salla e sekretariatit:	20	6, 7, 8, 9 Tetor	4
Sallë për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, Bordin Drejtues	14	7, 8, 9 Tetor	3
Salla e Asamblesë dhe e Forumit të Biznesit:	160	7, 8, 9	3

Emërtimi	Numri i personave	Datat në dispozicion	Nr. i diteve të shërbimit të kërkuar
Pushim kafe + biskota për sallën e sekretariatit	20	6,7,8,9 Tetor	4
Pushim kafe + biskota për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe të ftuarit	5	6,7,8,9 Tetor	4
Pushim kafe + biskota për Bordin Drejtues	12	7 Tetor	1
Pritje koktej mirsëardhje (darkë bufe)	140	7 Tetor	1

Drekë bufe për pjesëmarrësit (me ujë dhe pije freskuese), pa alkool	100	8 Tetor	1
Drekë bufe për CEO-t me ujë, pije freskuese dhe pak verë të kuqe/bardhë	60	8 tetor	1
Drekë bufe për pjesëmarrësit me ujë dhe pije freskuese, pa alkool	160	9 Tetor	1
Darkë bufe e largimit për pjesëmarrësit (Farwell)	140	9 Tetor	1
Transportin nga Tirana – Krujë – Tiranë (me minivan)	40	10	1
Bileta për të vizituar Muzeun Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu	40	10	1
Dreka në një vend/restorant në qytetin e Krujës për pjesëmarrësit	40	10	1

Emërtimi	Sasia
Roll-Up Promocional për Asamblenë e Përgjithshme të POSTEUROP	3
Broshurë Promocionale për Asamblenë Përgjithshme të PostEurop	160
Përshtatja e Logos së Eventit të Dedikuar për Asamblenë e Përgjithshme	
Set Materialesh Logjistike të Personalizuara për Konferencë(të shpjeguara më lart) përmban : Çantë kartoni, Bllok shënimesh, stilolaps, fletores	160
Baner promocional	1
Bexha dhe Litarë	180
Trekëndësh protokollar me emrat e delegacionit dhe vendit pjesëmarrës	160
Ftesë zyrtare për eventin	160
Fotografi të printuara (Family foto)	160
Mbajtëse Fotografie	160

Dhurata	160
Postacioni për ekspozim dhe shitje të pullës postare/produkteve filatelike (detajuar me të gjitha elementet më lart)	1

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Asambleja e Përgjithshme dhe Forumi i Biznesit të PostEurop në Tiranë, Shqipëri, 7-10 Tetor 2025, pritur nga Posta Shqiptare Sh.A.

Detyrat: Organizimi dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme për realizimin e eventit, përfshirë:

- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme sipas specifikimeve teknike për sallat e mbledhjeve dhe ambientet mbështetëse.
- Sigurimin e pajisjeve teknike audio-vizive dhe stafit teknik gjatë gjithë eventit.
- Organizimin e ushqimit dhe pijeve sipas kërkesave dhe kapaciteteve të përcaktuara.
- Sigurimin dhe shpërndarjen e materialeve promocionale dhe suvenireve për pjesëmarrësit.
- Organizimin e ekskursionit për delegatët në qytetin e Krujës me të gjitha shërbimet përkatëse (transport, biletë muzeu, drekë).
- Ofrimin e shërbimit të fotografimit dhe videografisë gjatë ditëve të eventit.

Shpërndarja: Shërbimet do të ofrohen dhe organizohen në përputhje me afatet dhe datat e përcaktuara në specifikimet teknike dhe planifikimin e eventit, duke siguruar mbulimin e plotë të periudhës 6-10 Tetor 2025 dhe mbulimin e kapaciteteve të kërkuara për secilin aktivitet.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Shërbimet duhet të ofrohen në ambiente të përshtatshme, pranë Selisë Qendrore të Postës Shqiptare Sh.A., në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të tenderit. Sigurimi i ambienteve dhe dorëzimi i materialeve duhet të realizohen sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këto specifikime.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022 - 2023 - 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës **së fondit limit që prokurohet**

a) Në rastin e përvojës së mëparshme nga një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohe vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim: *Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.*

